REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 179/22
Datë/Datum. 13.06.22
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Psh. nr. 179/22

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, nenin 108/A, nenin 118 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, si dhe nenin 17 paragrafi 3 të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, me numër të protokollit 83/2020, pas shqyrtimit të ankesës së OE "Swissmed shpk", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me reagensa për imunologji, gazore dhe elektrolite" me numër te prokurimit 701-22-1340-1-1-1, iniciuar nga AK-QKUK, Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit z. Ardian Behra me datën: 10 Qershor 2022, mori këtë:

VENDIM

- **Hedhet si jo e plotë,** ankesa e OE "Swissmed shpk", me nr. të protokolli 179/22, e datës 02. 06. 2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me reagensa për imunologji, gazore dhe elektrolite" me numër te prokurimit 701-22-1340-1-1-1, iniciuar nga AK- QKUK.

ARSYETIM

Organi Shqyrtues i Prokurimit, në sistemin elektronik me datë 02 Qershor 2022, ka pranuar ankesë nga OE "Swissmed shpk", për aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizim me reagensa për imunologji, gazore dhe elektrolite" me numër te prokurimit 701-22-1340-1-1-1.

Operatori ekonomik "Swissmed shpk", me datën 19. 04. 2022, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në autoritetin kontraktues kundër vendimit të AK-së. Autoriteti kontraktues me datën 21. 04. 2022 ka refuzuar vendimin e operatorit ekonomik ankues, dhe kundër këtij vendimi për refuzim operatori ekonomik me datën 22 Prill 2022 në sistemin e e-prokurimit ka parashtruar ankesë në OSHP.

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas analizimit të lëndës, sqaron se ankesa e operatorit ekonomik ankues është jo e plotë për faktin se OE ankues nuk ka paguar tarifën konform nenit 118 të LPP-së sepse të njëjtit kanë deklaruar se për të njëjtin aktivitet me datën 18 Mars 2022 ka parashtruar ankesën me nr. protokoli 61/22 me ç'rast OE ankues kanë pranuar raportin e ekspertizës së ekspertëve të OSHP-së, mirëpo, për shkak të mungesës së Bordit nuk ka një vendim përfundimtar lidhur me atë ankesë, dhe AK pasiqë ka pritur tejkalimin e afateve ligjore për shqyrtim nga paneli shqyrtues i OSHP-së ka hequr pezullimin automatik lidhur me aktivitetin e lartpërmendur. Kundër vendimit për heqje të pezullimit automatik OE ka parashtruar rishtazi kërkesë për rishqyrtim dhe pastaj ankesë në OSHP me datën 02 Qershor 2022 mirëpo nuk ka paguar tarifë sepse ka llogaritur tarifën e paguar për ankesën e parashtruar me numër protokoli 61/22 të datës 18 Mars 2022.

Zyra e pranimit të ankesave me datën 02 Qershor 2022, përmes email-it i ka shënuar OE ankues: " Ju njoftojmë se pasiqë keni parashtruar ankesë ju duhet të bëni fletëpagesën dhe pagesën e re

dhe të na e dërgoni dëshminë e kësaj pagese me qëllim që ne të vazhdojmë me procedurat tona", por OE nuk është përgjigjur në kërkesën e OSHP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konsideron se ankesa është e mangët dhe jo e plotë dhe nuk është konform nenit 118 të LPP-së ku thuhet:

1. Ankuesit duhet të paguajnë një tarifë të ankesave në OSHP vlera e së cilës do të përcaktohet nga KRPP-ja në legjislacionin dytësor. Dëshmia e pagesës duhet ti bashkëngjitet vetë ankesës në përputhje me nenin 111 të këtij ligji. Pagesa do të bëhet në para të gatshme ose në ekuivalent të parave të gatshme në një llogari të hapur nga OSHP-ja në përputhje me Rregullat Financiare.

2. OSHP nuk do të pranojë ankesën nëse tarifa nuk paguhet.

Duke u nisur nga sqarimet e dhëna si më lartë, OSHP konstaton se ankesa e parashtruar nga OE ankues, është e pakompletuar sepse kemi të bëjmë me një ankesë të re edhe pse është parashtruar për të njëjtin aktivitet të prokurimit dhe për të cilin akoma nuk kemi një vendim përfundimtar nga paneli shqyrtues për faktin se nuk ka Bord OSHP, andaj edhe e njëjta nuk mund të shqyrtohet.

Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT PRISHTINË/A TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI REPUBLIKA KOSOVA

Kryesuesi Sekretariatit të OSHP-së

z. Ardian BEHRA

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – QKUK

1x1 OE-" Swissmed" me seli në Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb - faqe të OSHP-së